



KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



Roskovec

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2020-2023

- Roskovec -

Planet
Lokale të
Veprimit

Jeta Qytetin Tënd





Jeta Qytetin Tënd

Përmbajtja

I. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

1.1 Qëllimi.....	06
1.2 Metodologjia	07
1.3 Parimet Udhëheqëse	09

II. BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE 10

III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE PLANIFIKIMI 12

IV. ANALIZA SWOT 19

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI 20



**PËR REALIZIMIN E KËTIJ
PLANI LOKAL VEPRIMI PUNUAN:**

**Koordinator Lokal dhe Hartues:
Lusiana Mailaj**

Shoqata "Njerëzit të Parët", Roskovec

Ekspert Lokal:

Marina Viktoria Hysenj,

Shoqata "Njerëzit të Parët", Roskovec.

Pikë kontakti Bashkia:

Eralda Duraj

Kryeinspektore Arsimit dhe Higjenës, Roskovec.

Koordinimi në nivel kombëtar dhe asistimi në hartim:

Sekretariati i Kongresit Rinor Kombëtar:

Dafina Peci,

Drejtoreshë Ekzekutive.

Korrektim dhe Kurim:

Shila Parllaku,

Oficere Komunikimi

Falenderime

Plani Lokal i Veprimit për Rininë u bë i mundur falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar.

Puna e zhvilluar në nivel kombëtar për planet e veprimit 2020-2023 në 12 Bashki ka pasur synim nxitjen e dialogut të strukturuar rini-institucione, në bazë të një metodologjie dhe rrugëtimi të njehsuar, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat aktive të Kongresit Rinor Kombëtar dhe me gjerë, të rinj nga shkollat e mesme dhe universitetet, si dhe me mbështetjen e madhe dhe angazhimin sistematik të Bashkive.

Këto plane do shërbejnë si një bazë orientuese politikash dhe veprimtarie të dedikuar për sektorin e rinisë, në përputhje të plotë me perceptimet dhe vizionin që të rinjtë dhe institucionet kanë mbi perspektivën lokale.

Një falenderim shkon për të gjithë ata që u bënë pjesë dhe kontribut në këtë rrugëtim!



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bashkia Roskovec me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert në bashkëpunim me Kongresi Rinor Kombëtar ka hartuar Planit Lokal te Veprimit për Rininë, dhe nëpërmjet këtij dokumenti prezanton përpjekjen e saj më serioze për të ndërhyrë thellë e në mënyrë gjithëpërfshirëse për transformimin e realitetit ku jetojnë, studiojnë dhe ëndërrojnë të rinjtë e qytetit.

Vizioni ynë për vitet e ardhshme projekton krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre. Prioritetet do të jetë përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe rritjen e pjesëmarrjes së plotë të të rinjve në shoqëri dhe vendimarrje.

Gjashtë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet SVR janë pjesë integrale e

“Strategjisë Europiane për të Rinjtë 2019-2027” dhe në koordinim të plotë me të gjithë dokumentat strategjike në nivel qendror dhe vendor. Në evidencimin e këtyre shtyllave rol të rëndësishëm patën analiza e situatës aktuale dhe analiza SWOT e të gjithë fushave që janë kompetencë e Bashkisë. Potencialet dhe problematikat e evidentuara janë ndërthurur dhe kombinuar duke formuluar këto objektiva:

Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës adreson mangësitë fizike dhe materiale, si edhe vështirësinë e aksesit në institucione edukuese, për shkak të aftësive, përkatësisë në një grup vulnerabël apo të marginalizuar etj. Ky prioritet përmbledh dhe adreson të gjitha nivelet e arsimit në territorin e Bashkisë Roskovec. Objektivat dhe masat për këtë prioritet janë ndërtuar duke marrë në konsideratë mundësitë ekzistuese për zgjidhjen e këtyre problematikave dhe, njëkohësisht, duke parashtruar masa që mund të ndërmerren drejt zgjidhjes.

Punësimi dhe sipërmarrja rinore përfshin dhe adreson papunësinë e të rinjve (duke përfshirë sidomos angazhimet sezonale ose studentore), efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e politikave që janë në fuqi, vetëpërfshirjen e të rinjve dhe palëve të treta në organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare e më tej.

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimmarrje merret drejtpërdrejtë me përfaqësimin e të rinjve për të marrë pjesë në Këshillin Bashkiak si organ përfaqësues i Bashkisë, me mundësitë dhe motivimet e të rinjve dhe të rejave për të marrë pjesë drejtpërdrejtë në politikëbërje dhe vendimmarrje në Bashkinë Roskovec. Në këtë kontekst, për të arritur në konkretizimin e masave të sugjeruara, janë analizuar nisma të mëparshme dhe efektshmëria e tyre, si edhe janë marrë në konsideratë nisma ekzistuese.

Art, sport, kulture dhe mjedisi përfshin dhe adreson kohën e lirë, nevojën argëtim dhe promovimin e të rinjve virtuozë dhe të talentuar adreson cilësinë e jetës së shëndetshme dhe një qytet me ajër të pastër, nxitjen dhe zhvillimin e turizmit. Masat janë orientuar drejt krijimit të hapësirave, aktiviteteve, programeve, mundësive kulturore, hapësirave për të

ushtruar sportin, për të bërë art dhe aktivitete të tjera krijuese dhe argëtuese.

Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore në qytetin e Urës Vajgurore parashikon jo vetëm një përjasje mbështetëse nga ana e Bashkisë Roskovec, por edhe një ndërveprim aktiv, në mënyrë që të ketë sa më shumë nisma cilësore nga ana e të rinjve. Për këtë, prioritetet dhe masat janë orientuar drejt mundësive financiare dhe aktiviteteve konkrete që ndihmojnë organizatat grupimet dhe nismat rinore, në mënyrë që të funksionojnë si duhet dhe të kenë qëndrueshmëri.

Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe lehtësirash që të rinjtë përfitojnë për shkak të grupmohës në të cilën ata bëjnë pjesë. Realizimi i këtyre shërbimeve dhe përfitimi që do të kenë të rinjtë, do të sillte përmirësimin e gjendjes dhe mirëqënies së tyre në qytet dhe, për rrjedhojë, mirëfunksionimin e tyre efektiv si qytetarë të kësaj Bashkie.

1.1 QËLLIMI

Dinamikat qeverisëse në Shqipëri po orientohen gjithnjë e më shumë drejt hartimit dhe zbatimit të politikave në nivel vendor, kjo në vazhden e decentralizimit të pushtetit qëndror dhe mbështetjes së autonomisë së Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV) për përmbushjen e funksioneve të përcaktuara me ligj. Politikat dhe dokumentat strategjike sektoriale janë instrumenta të nevojshëm për të udhëhequr sektorë të veçantë, në përputhje të plotë me funksionet dhe kuadrin ligjor.

Qëllimi i këtij Plani Veprimi është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxisë zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në veçanti, pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit socioekonomik të saj përbëjnë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve europiane dhe një ekonomie tregu të aftë për t'u përballur me sfidat e globalizimit.

Plani Lokal i Veprimit frymëzohet nga vizioni european mbi angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, mbrojtjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve në Bashkinë Roskovec. Përparësitë e angazhimit strategjik synojnë

shfrytëzimin optimal të burimeve në dispozicion dhe një bashkërendim të punës jo vetëm ndërmjet strukturave të Bashkisë Roskovec që kontribuojnë në zhvillimin e rinisë por edhe bashkërendimin e punës së institucioneve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në fokus do të jetë dhe krijimi i sinergjive nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile, organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve.

Strategjia synon që të nxisë aktivizmin rinor dhe rritjen e kapaciteteve për të rinjtë në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi dhe hapësira në të ardhmen. Bazuar gjithashtu në qëllimin dhe objektivat e "Strategjisë Europiane për të Rinjtë 2019-2027", strategjia vendore për të rinjtë synon që të bashkojë të rinjtë për ndërtimin e një qyteti pa barriera, duke e kthyer kështu qytetin në një hapësirë të dedikuar për brezat e rinj.

Planet
Lokale të
Veprimit

Jeta Qytetin Tënd 



1.2 METODOLOGJIA

Studimi është realizuar në nivel kombëtar dhe shtrirë në 12 bashki në fokus, ku 10 prej tyre janë bashki qender qarku. Ai është konceptuar të realizohet në disa faza, të përcaktuara dhe detajuara në vijim. Realizues dhe Zbatues të studimit do të jenë KRK dhe rrjeti i organizatave nëpërmjet kordinimit dhe punës në terren nga 12 koordinatorët lokal.

Për cdo Bashki, do të jetë 1 koordinator lokal në bashkëpunim me subjektet pjesë e rrjetit të KRK, e cila është përgjegjëse për realizimin në terren të studimit dhe për përfshirjen e gjetjeve nga studimi në Planet Lokale të veprimit sipas secilës Bashki përkatësisht. Theksojmë se studimi është realizuar në të gjithë territorin në mbulim të Bashkisë respektive, pra duke konsideruar edhe ish-komunat, sot njësitë Administrative.

Studimi është i ndarë në **këto faza:**

1. Faza e parë është krijimi i backgroundit të Research Topic (Nevoja e hartimit të planeve lokale të veprimit për rininë). Kjo fazë përfshin:

- Hulumtimi në literaturën (Praktikat në Rajon dhe Rregullimet Ligjore përkatëse)
- Përcaktimi i metodologjisë së kërkimit
- Përcaktimi i kuadrit teorik (Legjitimimi i kërkimit) dhe karakteri aplikativ i tij (përse

na duhet? Dhe çfarë na sjell?)

2. Faza e dytë është mbledhja e të dhënave cilësore: të tipit të raporteve; të dhënave të publikuara për situatën e të rinjve në nivel vendor për 6 fushat e përcaktuara. Kjo fazë përfshin:

- Evidentimi i të gjitha problematikave që lidhen me informacionin/informimin e të rinjve për hapësirat/mundësitë reale të përfshirjes dhe angazhimit të tyre në 6 fushat prioritare të përcaktuara.
- Evidentimi i raportit buxhet i parashikuar-buxhet i shpenzuar për aktivitete dhe zbatimin e politikave rinore (Ballafaqimi i kërkesave/nevojave i Ri (e)- Pushtet Vendor).
- Përcaktimi i nevojave dhe prioriteteve komunitare e lokale sipas secilës fushë që Plani Lokal i Veprimit mendohet të përfshijë.
- Kapacitetet e pushtetit lokal dhe për përmbushjen e kërkesë-nevojave komunitare për të rinjtë.

3. Faza e tretë ka të bëjë me skicimin e Research Design-it nga secila Organizatë për secilën Bashki përkatësisht, sipas vendit ku ato operojnë:

- Formulimi i Hipotezës;
- Formulimi i Pyetjeve Kërkimore;
- Nxjerrja e Implikimeve;
- Nxjerrja e Indikatorëve/treguesve për Studimin.

4. Faza e katërt ka të bëjë me përcaktimin e të dhënave të tilla si:

- Lloji i kampionimit që do të përdoret/ si? Dhe ku? do të mbledhen të dhënat.
- Sa persona do të pyeten/madhësia e kampionimit në nivel kombëtar.
- Nga cilat grupmosha do të nis studimi.
- Sa persona do të pyeten për secilën bashki.
- Listimi i indikatorëve/ përkthimi i tyre në pyetje.

- Cilat alternativa nxjerrin më në pah problemin kërkimor (Mangësitë e konstatuara në nivel lokal specifikisht, evidentimi i nevojave, identifikimi i prioriteteve sipas objektivave strategjike për planet lokale të veprimit).

Kjo fazë është e përbërë nga këto etapa:

- Skicimi i Kampionimit - kjo do të bëhet secifikisht për secilën Bashki në program.
- Hartimi i pyetësorit - bazuar në indikatorët për 6 fushat prioritare për të rinjtë.
- Pre-testimi i Pyetësorit - (sa i kuptueshëm dhe i realizueshëm është për t'u arritur). Evidentimi dhe reflektimi i ndryshimeve/draftimi final i pyetësorit.



5. Faza e pestë ka konsistuar në realizimin në terren të procesit të anketimit (2400 pyetësorë gjithsej) dhe mbledhja e të dhënave sasiore. Kjo fazë u zhvillua në 2 muaj, ku puna në terren me pyetësorët zgjati një javë të plotë dhe u angazhuan në terren 12 koordinatorët lokal me ndihmesë nga vullnetarë dhe asistues sipas nevojës.

6. Faza e gjashtë është checkimi i pyetësorëve dhe hedhja e të dhënave. Krijimi i një baze të plotë të dhënash në excel.

7. Faza e shtatë është përpunimi statistikor (frekuenca dhe crosstabe) i të dhënave në SPSS sipas implikimeve të përcaktuara në fazën e tretë.

8. Faza e fundit është përpilimi i raportit me gjetjet, përfundimet, dhe rekomandimet përkatëse.

9. Hartimi i Planeve Lokale të Veprimit për secilën Bashki, bazuar në procesin e mësipërm.



PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet të cilat kanë udhëhequr procesin e hartimit të PLR-së, janë edhe parimet mbi të cilat Bashkia Roskovec synon të ndërtojë të ardhmen e qytetit me qytetarët. Më konkretisht këto parime konsistojnë në:

Zhvillimi i qëndrueshëm: Ky parim ka udhëhequr gjithë procesin e hartimit të PLR-së dhe udhëheq njëherazi gjithë strategjitë kryesore kombëtare, rajonale dhe vendore. Pra është e rëndësishme që shfrytëzimi i burimeve të bëhet në mënyrë sa më të balancuar dhe nëpërmjet një planifikimi të integruar për të arritur zhvillim ekonomik dhe social që garanton qëndrueshmëri në kohë dhe jetëgjatësi. Ky parim është thelbësor kur flitet për të ardhmen e rinisë, motorrit kryesor të shoqërisë shqiptare.

Subsidiariteti: Strategjia është hartuar duke pasur parasysh që ushtrimi i përgjegjësive publike duhet në mënyrë të përgjithshme, t'iu takojë më tepër autoriteteve të cilat janë më pranë qytetarëve ku dhe impakti është më i madh. Bashkia Roskovec që prej vitit 2015 ka pasur në fokus të veçantë rininë nisur edhe nga fakti se zhvillimi dhe integrimi i të rinjve është cilësuar gjithmonë si guri i themelit të një shoqërie të fortë.

Bashkërendimi: Kjo strategji ka synuar të koordinohet me kuadrin strategjik të zhvillimit të Bashkisë Roskovec, duke ndjekur objektivat dhe parimet thelbësore të zhvillimit të përcaktuara në dokumentat strategjike vendore. Në të njëjtën

mënyrë, PLR është përpjekur të jetë në harmoni me interesat e shoqërisë civile dhe organizimeve rinore duke promovuar forma të ndryshme bashkëqeverisjeje apo bashkëpunimi për një zhvillim të qëndrueshëm. Përpjekjet e organizuara të të gjithë niveleve qeverisëse të mbështetura edhe nga organizatat rinore do të fuqizojnë rolin e të rinjve në të gjitha fushat.

Llogaridhënia dhe Transparenca: Qëllimet dhe objektivat strategjike, të përcaktuara në këtë strategji janë përkthyer në projekte dhe aktivitete specifike të matshme nëpërmjet treguesve të performancës, duke i bërë këto objektiva lehtësisht të matshme dhe të monitorueshme.

Gjithëpërfshirja: Strategjia ka patur në fokus kryesor filozofinë e gjithëpërfshirjes sociale duke u përpjekur në trajtimin e problematikave kryesore të çdo grupi social, me një vëmendje të lartë ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Kjo nënkupton, krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë të rinjtë e Bashkisë Roskovec duke i ndihmuar ata në arritjen e mirëqënies së përbashkët.

Fleksibiliteti: Duke marrë në konsideratë reformat e shumta që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë gjatë pesë viteve të fundit dhe ndryshimet thelbësore që kanë prekur funksionet dhe kompetencat e NJQV-ve, strategjia është hartuar në mënyrë të tillë që të lejojë hapësirat e nevojshme për t'iu përshtatur kontekstit politik ende në ndryshim e sipër. Kjo do të thotë se objektivat strategjike dhe projektet janë hartuar duke marrë parasysh disa skenarë zhvillimi për të arritur përmbushjen më optimale të tyre përgjatë kësaj periudhe tranzicioni.

BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE

Vizioni i këtij dokumenti orientues e strategjik për tre vitet e ardhshme kërkon vendosjen e rinisë në fokus të jetës aktive të qytetit nëpërmjet mbështetjes së partneritetit dhe nxitjes së bashkëpunimit me të rinjtë e vendeve Europiane. Në mënyrë që të realizohet ky vizion afat-mesëm, është parësore që të bashkërendohet me planet kombëtare afat-mesme dhe afat-gjata dhe të ketë koordinim më efikas me organizatat rinore dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces.

Mungesa për një kohë të gjatë e kuadrit ligjor për rininë ka bërë që përfshirja e të rinjve në jetën publike, vendimmarrje politike dhe shërbimet e dedikuara për rininë të jenë në vullnetin e titullarëve të institucioneve publike. Mungesa e kuadrit ligjor ka bërë që edhe bashkëpunimi jo vetëm ndër-institucional por ndërmjet rrjetit të shoqërisë civile dhe organizatave rinore të jetë i pastruktuar dhe nuk përfshin të gjitha aspektet ku përfshihet rinia. Prandaj gjatë procesit të hartimit të Planit Lokal të Veprimit të Rinisë 2020-2023 janë marrë në konsideratë objektivat e politikave dhe planeve kombëtare, rajonale dhe vendore për të krijuar një kuadër zhvillimor më koherent dhe të qëndrueshëm dhe sa më pranë standardeve të Bashkimit Europian (BE).

Në nivel ndërkombëtar:

>>> **Strategjia e BE-së për Rininë**, e cila advokon fuqishëm për “punën e të rinjve” një koncept holistik që shkon përtej punësimit dhe mbulon aspekte të ndryshme të zhvillimit personal të të rinjve. Siç është

përcaktuar në Strategjinë e Rinisë të BE-së, ka të bëjë me “fugizimin, emancipimin, përgjegjësinë dhe tolerancën...”.

>>> **Strategjia Europa 2020** ka qëllim nxjerrjen e 20 milion njerëzve nga varfëria, luftën ndaj përjashtimit social dhe forcimin e punësimit. Iniciativat kryesore nën këtë strategji janë Platforma kundër Varfërisë dhe Përfshirjes Sociale dhe Aftësi për Aftësi të reja dhe Vende pune.

>>> **Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020** është në thelb të Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen Sociale 2007-2016, e cila përcakton mekanizmat dhe strategjitë për përfshirje sociale gjatë ciklit të jetës së individëve si: fëmijët, individët në moshë pune, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet. Për më tepër, është mbështetur nga programi i Progresit, një instrument financiar që ka për qëllim zhvillimin e politikave në 5 fusha strategjike: punësimi, mbrojtja dhe përfshirja sociale, kushtet e punës, anti-diskriminimi dhe barazia gjinore.

Në nivel kombëtar:

>>> **Programi i Qeverisë 2017-2021** Ky program në seksionin e rinisë, parashikon hartimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike, programe dhe projekte për nxitjen e punësimit, krijimin e një kuadri ligjor të qartë për rininë ku përcaktohen qartë kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisjes lidhur me përgjegjësitë që kanë ndaj të rinjve, si dhe forcimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.



>>> Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (SKZHI) përcakton një qasje të integruar për zhvillimin socio-ekonomik të vendit po ashtu dhe për integrimin në BE. Impakti që kjo strategji kërkon është në 3 këndvështrime: së pari, një zhvillim ekonomik më i madh përmes rritjes së tregut të punës, forcimit të arsimit – duke përfshirë arsimin dhe trajnimin profesional, vullnetarizmin dhe minimizimin e ekonomisë informale. Së dyti, ka qëllim shndërrimin e rritjes ekonomike në mirëqenie sociale, përmes investimit në shërbime publike që ndihmojnë përfshirjen, kohezionin dhe cilësinë e jetës. Aksi i tretë i strategjisë bazohet në fuqizimin e qeverisjes, demokracinë dhe parametrat e ligjit të së drejtës.

>>> Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020 ka qëllim ndërtimin e një fuqie punëtore më të arsimuar dhe të aftë sipas nevojave të tregut të punës. Politikat prioritare të identifikuar janë: a) forcimi i mundësive të punësimit përmes politikave efektive të tregut të punës, ku ofrimi i sa më shumë mundësive për të rinjtë është një prioritet; b) ofrimi i arsimit dhe trajnimit profesional cilësor dhe trajnimit të të rinjve dhe të rriturve; c) nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial; dhe d) forcimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.

>>> Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020 – harton një plan për ndërtimin e një sistemi të mbrojtjes sociale ku individët fuqizohen dhe grupeve vulnerabël iu ofrohen oportunitete që i bëjnë ata më shumë autonomë shoqëruar kjo me mekanizmat parandalues dhe të ri-integrimit në shoqëri.

>>> Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 – Ky plan ka për qëllim hartimin e politikave të tërthorta për integrimin e plotë të të rinjve në

skemën e shëndetësisë, arsimit, punës sociale dhe pjesëmarrjes politike me qëllim që ata të bëhen anëtarë aktiv të shoqërisë në të gjitha aspektet. Ky plan veprimi është bazuar në 6 objektiva strategjik si: Nxitja e të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre në proceset demokratike/vendimmarrje; Nxitja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës; Shëndetësia; Sporti dhe Mjedisi; Arsimi i të rinjve; Mbrojtja sociale; Kultura dhe Vullnetarizmi.

>>> Plan Kombëtar Veprimi 2010-2015 për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve - Plani është bazuar në një qasje të plotë që targeton minoritetet me qëllim përfshirjen e tyre. Kështu, politikat variojnë nga shërbime bazike si shëndetësia, arsimi, punësimi dhe strehimi; në shërbime më të sofistikuara si mbrojtja e trashëgimisë kulturore.

Në nivel Lokal:

>>> Plani Operacional i Zhvillimit Lokal 2016-2019 - Plani Operacional i Zhvillimit Lokal (POZHL) është një instrument planifikimi për Bashkinë Roskovec dhe pjesë integrale e zbatimit të Reformës Territoriale-Administrative, si dhe planifikimit të zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor dhe urban që do të kryhet në të ardhmen.

>>> Plan Lokal Veprimi 2019 – 2022 për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve - targeton pakicat rome dhe egjiptiane dhe paraqet në mënyrë të detajuar masat që do të zbatohen në kuadër të politikave të Bashkisë Roskovec për fushat prioritare të planit. Ky plan është hartuar me mbështetjen e programit ROMACTED të Këshillit të Europës dhe ka për qëllim integrimin e këtij komuniteti në pesë fusha prioritare: Arsimi, Punësimi, Strehim, Kujdesi Shëndetësor dhe Shërbimet Sociale.




MATRICA E BASHKËRENDIMIT ME DOKUMENTAT STRATEGJIKE NDËRKOMBËTARE, KOMBËTARE DHE VENDORE

OBJEKTIVAT E STRATEGJISË VENDORE PËR RININË

DOKUMENTET STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT E STRATEGJISË VENDORE PËR RININË					
	Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës	Punësimi dhe sipërmarrja Rinore	Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimmarrje	Art, sport, culture dhe mjedisi	Mbështetja e organizatave dhe nismave Rinore	Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbime publike për të rinjtë
Strategjia e BE-së për Rininë						
Strategjia Europa 2020						
Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020						
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020						
Programi i qeverise 2017 – 2021						
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020						
Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020						
Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 -2020						
Plani Kombëtar Veprimi për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianë						
Ligji mbi “Barazinë gjinore në shoqëri”						


III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE PLANIFIKIMI

ARSIMI CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS				
SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
<p>Në qytetin e Roskovecit ka nevojë të theksuar për infrastrukturë fizike më e mirë në shkolla, pajisje me laboratorë në lëndë specifike dhe gjithashtu këshillim karriere.</p> <p>Ato që janë konsideruar si nevojat aktuale më të rëndësishme të këtij prioriteti janë: përmirësimi i kurrikulave mësimore; ngritja e bibliotekave; zvogëlimi i numrit të nxënësve nëpër klasa; kualifikimi i vazhdueshëm i mësuesve; shtimi i mësuesve ndihmës në shkollë dhe mbështetja e talenteve të reja.</p>	<p>1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies, duke përmirësuar infrastrukturën dhe metodologjinë e mësimdhënies.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1) Projektet e planifikuara për rikonstrukcion. 2) Të dhëna dokumentuese të projekteve të zbatuar. 3) Numri i nxënësve dhe stafit përfitues. 4) Numri i shkollave përfituese. 5) Numri i aktiviteteve / orëve të realizuara. 	<ol style="list-style-type: none"> 1.1 Rikonstruktimi i plotë i gjimnazit “Adem Vrapit”. 1.2 Organizimi i konkurseve shkencore, kulturore dhe artistike mes shkollave. 1.3 Zhvillimi i orëve informuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi mjedisin, trafikimin, diskriminimin, dhunën me bazë gjinore, sinjalistikën rrugore. 1.4 Zhvillimi i orëve praktikë si të vepruara në rast tërmeti, si të japim ndihmën e pare. 1.5 Rikonstrukcioni i shkollës “Zylyftar Veleshnja” në Velmisht. 	




PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
Nevojat aktuale të të rinjve të Roskovecit janë: organizimi i kurseve profesionale, zhvillimi i internshipeve dhe traineeshipeve; orientim drejt tregut të punës; krijimi i mundësive për punësim sezonal për të rinjtë; ngritja e qendrave profesional afër qendrave të banuara; punësim me anë të konkurseve; politika më të mira punësimi; zhvillimi i kampeve verore; informim më i mirë për mundësi punësimi / trajnimi.	1. Rritja e kapaciteteve të të rinjve për tu integruar sa më mirë në tregun e punës.	<ol style="list-style-type: none"> 1) Numri i trajnimeve të zhvilluara për të rinjtë mbi sipërmarrjen, legjilacionin tatimor, procedurat vendore, mundësitë e biznesit, etj. 2) Numri të rinjve të trajnuar. 3) Numri i bizneseve rinore të inkubuar. 4) Numri i bizneseve rinore të mbështetura apo promovuara. 	<ol style="list-style-type: none"> 1.1 Ofrimi i trajnimeve dhe kurseve të formimit për të rinjtë mbi sipërmarrjen, legjilacionin tatimor, mundësitë e biznesit, procedurat vendore etj. 1.2 Programe për mbështetjen dhe qëndrueshmërinë e Inkubatorëve të Biznesit. 1.3 Promovimi dhe nxitja e bizneseve inovatore dhe atyre sociale rinore. 1.4 Ngritje e kapaciteteve të të rinjve për të shkruar CV, letër motivimi, si të sillen gjatë një interviste për punë, etj nga Këndi i BE-së pranë Bashkisë. 	



MBËSHTETJA E ORGANIZATAVE RINORE DHE NISMAVE RINORE

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
Në qytetin e Roskovecit ka nevojë për: krijimin i bordeve rinore; përfshirjen e grupeve rinore në takimet e Këshillit Bashkiak; përfshirje e barabartë gjinore dhe e pakicave në vendimmarrje; ndërtimin e programve edukuese rreth politikëbërjes; vizita të grupeve rinore në institucione politikëbërëse; rritja e interesit të të rinjve në politikë; pjesëmarrja e të rinjve në mbledhjet e Këshillit Bashkiak; informim më i mirë dhe këshillim me të rinjtë për politikat rinore.	1. Sigurimi i qëndrueshmërisë së nismave rinore dhe organizimi i të rinjve.	<ol style="list-style-type: none"> 1) Numri i të rinjve të angazhuar në zbatimin e aktiviteteve që organizon Bashkia Roskovec. 2) Numri i aktiviteteve rinore të organizuara në Qendrën Social Komunitare. 3) Numri i projekteve/aktiviteteve të zbatuara në bashkëpunim me OJF vendore. 4) Numri i bashkëpunimeve me OJF të tjera. 5) Marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata / grupe të ndryshme rinore. 6) Numri i shkëmbimeve rinore të realizuara me Bashki të tjera. 	<ol style="list-style-type: none"> 1.1 Mbeshtetja e të vetmes organizatë lokale. 1.2 Forcimi i partneriteteve me organizata te tjera rinore në nivel lokal dhe kombëtar. 1.3 Nxitja e grupit aktiv të të rinjve të Qendrës Social Komunitare. 1.4 Krijimi i mundësive për shkëmbime rinore me të rinjë në Bashki të tjera. 1.5 Angazhimi dhe përfshirja e grupeve rinore në festat dhe aktiviteteve e përvitshme që organizon Bashkia Roskovec. 	



ARTI, SPORTI, KULTURA DHE MJEDISI

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
<p>Ngjitja e terreneve sportive brenda dhe jashtë shkollave; shtimi hapësirave të gjelbëruara; promovimi i talenteve në sport dhe art; organizim i më shumë shfaqjeve / ekspozitave; përmirësimi i kushteve të bibliotekës; nxitja e sporteve të reja; më shumë kosha për mbeturinat në zonat rurale; mirëmbajtje e godinave aktuale rinore; edukim mjedisor dhe konkurse kulturore janë disa nevoja emergjente në kuadër të këtij prioriteti.</p>	<p>1. Nxitja e aktiviteteve artistike, sportive, kulturore dhe mjedisore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1) Numri i nxënësve, klasave, shkollave, personelit pjesëmarrëse në kampionatet sportive. 2) Numri i aktiviteteve kulturore, artistike, sportive të mbështetura. 3) Numri i aksioneve të pastrimit të realizuara. 4) Numri i shfaqjeve, ekspozitave, takimeve letrare të zhvilluara. 5) Numri i festave të zhvilluara. 6) Numri i talenteve rinore të mbështetur financiarisht në sport. 	<ol style="list-style-type: none"> 1.1 Zhvillimi i kampionateve sportive të ndryshme midis shkollave dhe të rinjve pjesë e personelit arsimor, Bashkisë Roskovec dhe njësie administrative në varësi. 1.2 Promovimi i talenteve në fushën e artit, sportit, kulturës. 1.3 Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe fushatave vendore të pastrimit. 1.4 Organizimi i shfaqjeve, ekspozitave, takimeve letrare/kulturore, panaire. 1.5 Organizimi i festive tradicionale të përvitshme si Festa e Ullirit, Festa e Qytetit, etj. 	

ÇËSHTJET SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE SHËRBIMET PUBLIKE

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
<p>Qendra Sociale Komunitare është pika e vetme e takimit për aktivitete socio-kulturore të të rinjve të Bashkisë Roskovec. Aty zhvillohen kurse profesionale dhe aktivitete të ndryshme për të rinjë të cilët angazhohen vazhdimisht pranë saj. Një tjetër strukturë që organizon aktivitete me qëllim ngritjen e kapaciteteve të të rinjëve të Bashkisë Roskovec është edhe Këndi i BE-së. Ky kënd zhvillon takime informuese dhe trajnime periodike mbi tema sociale si orientim për karrierën, vullnetarizmi, barazia gjinore, simpërmarrja, anagzhimi rinor në vendim-marrje, të drejtat e njeriut, etj.</p>	<p>1. Ngritja dhe përmirësimi i shërbimeve të përkujdesit social dhe shoqërore për të rinjtë dhe kategori në nevojë.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1) Numri i përfituesve të shërbimit shëndetësor 24 orë. 2) Numri i përfituesve të kujdesit ditor të qendrës PAK. 3) Numri i përfituesve të shërbimeve të zyrës më një ndalesë. 4) Dokumenta të tjerë mbështetës për zbatimin e projekteve rehabilituese. 5) Numri i aktivitete rinore të zhvilluara në Qendrën Social Komunitare. 6) Numri i personelit të shtuar të QSK dhe kurset e zhvilluara. 	<ol style="list-style-type: none"> 1.1 Rikonstruktimi i qendrës shëndetësore 24 orëshe. 1.2 Ngritja e qendrës së kujdesit ditor PAK në bashkëpunim me USAID. 1.3 Rindërtimi i Bashkisë Roskovec dhe integrimi i njësisë One-stop-shop pranë saj. 1.4 Ngritja e muzeut të Roskovecit. 1.5 Rehabilitimi dhe ngritja e këndeve shlodhëse dhe argëtuese midis lagjeve. 1.6 Zhvillimi i përhershëm i aktiviteteve rinore në Qendrën Social Komunitare dhe mobilimi dhe pajisja e saj me mjete për klasat/kurst e ndryshme. 	



Jeta Qytetin Tënd



IV. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një metodë planifikimi e strukturuar që përdoret gjerësisht për të evidentuar dhe vlerësuar Pikat e Forta (Strengths), Pikat e Dobëta (Weaknesses), Mundësitë (Opportunities) dhe Rreziqet/ Sfidat (Threats) të një projekti, çështjeje, territori, etj.

Gjatë hartimit të këtij Plani Veprimi, kjo metodë u përzgjedh si një instrument mjaft praktik dhe i dobishëm për të analizuar situatën ekzistuese, analizë mbi bazën e të cilës u hartuan qëllimet dhe objektivat strategjike. Pikat e dobëta dhe Pikat e forta evidentojnë çështje shqetësuese të të rinjve brenda territorit të Bashkisë Roskovec, të cilat mund të adresohen nëpërmjet politikave vendore, ndërsa Mundësitë dhe Sfidat i përkasin aspekteve të jashtme, kontrolli i të cilave mund të kërkojë bashkëpunim ndërvendor apo angazhim të qeverisë vendore e më gjerë.

PIKAT E FORTA

- > Pjesëmarrja e të rinjve në veprimtari artistike dhe kulturore
- > Aktivitete sportive dhe edukative
- > Mbështetja e programeve start-up
- > Përkrahja e talenteve të reja
- > Përkrahja e komunitetit Romë
- > Angazhimi i të rinjve në shërbime komunitare
- > Pjesëmarrja e të rinjve në programet e kujdesit social

S

PIKAT E DOBËTA

- > Mungesa e kuadrit ligjor
 - > Mungesa e organizatave rinore lokale
 - > Mungesa e informacionit në lidhje me sportin dhe kujdesin për shëndetin, SST, drogën, alkoolin
 - > Mungesa e kurrikulave arsimore për nxitjen e aktivizmit rinor
 - > Mungesa e infrastrukturës arsimore në fshatrat përreth
 - > Mungesa e mjediseve shlodhëse/ rikrijuese

W

MUNDËSITË

- > Trajnime për aftësitë në biznes për të rinjtë
- > Konkurse për talente të ndryshme për të rinjtë
- > Mbështetje me orientime profesionale dhe kualifikime
- > Nxitja e vullnetarizmit
- > Edukimi mjedisor
- > Nxitja e punësimit për të rinjtë e komunitetit Romë
- > Interes i vazhdueshëm nga investitorë
- > Thithja e fondeve ndërkombëtare
- > Bashkëpunim me organizatat rinore kombëtare/bashkive të tj

O

KËRCËNIMET

- > Fond i vogël për rininë
- > Buxhet i kufizuar
- > Pjesëmarrje e ulët e të rinjve në vendim marrje
- > Procedurat e shumta burokratike
- > Mungesa e sistemit për sigurimin e mbrojtjes sociale të të rinjve
- > Mjedis i ndotur nga industria naftënxjerrëse përreth

T

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SVR-së

Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit janë një komponent thelbësor për të përmirësuar efektivitetin e vetëqeverisjes vendore. Monitorimi dhe vlerësimi siguron informacion mbi zbatimin e objektivave dhe programeve, që i mundëson Bashkisë Roskovec të përfitojë nga sukseset dhe të mësojë nga eksperiencat e zbatimit. Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit kërkon përpjekje të përkushtuara, ekspertizë, aftësi, vlerësim dhe menaxhim të mirë. Ky proces konsiderohet si një nga më të rëndësishmit gjatë periudhës së zbatimit të një dokumenti strategjik, pasi shpesh devijimet nga përmbushja e objektivave të SVR 2019- 2023. Me qëllim që të sigurohet monitorim dhe raportim cilësor dhe i dobishëm, është e nevojshme që të përcaktohet si më poshtë vijon:

- Procesi i qartë i raportimit dhe i monitorimit me përgjegjësitë dhe kalendarin;
- Modelet dhe instrumentet që do të përdoren për monitorimin;
- Kapaciteti i strukturave kryesore dhe pjesëmarrëse.

Procesi i qartë i monitorimit dhe raportimit është i nevojshëm për të informuar pjesëmarrësit për përgjegjësitë e tyre dhe për t'u mundësuar atyre që të përgatiten për të gjitha angazhimet duke u bazuar në një kalendar të përcaktuar më parë. Sistemi i monitorimit duhet të jetë i mirëorganizuar për të ndjekur të gjitha hallkat që të mbulohen të gjitha projektet dhe të përcaktohen dhe konfirmohen strukturat monitoruese.

Modelet dhe instrumentet janë të nevojshme për rrjetin e komunikimit mes strukturave dhe për të garantuar se paraqitja e informacionit është e pajtueshme dhe e lehtë për t'u konsoliduar. Udhëzimet se si të plotësohen modelet duhet të jenë të përgatitura në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Përveç modeleve për elementë si objektivat do të jenë të nevojshme edhe sqarimet, sidomos në rastet kur vërehen vonesa apo mangësi për të detajuar elementët që sjellin devijime serioze. Informacioni i prodhuar përmes sistemeve të monitorimit dhe të raportimit mund të përdoret brenda Bashkisë Roskovec për të marrë vendime dhe jashtë saj për të siguruar transparencë për publikun e gjerë.

Kapaciteti i strukturave për të prodhuar informacion cilësor dhe për të konsoliduar informacionin është shumë i rëndësishëm. Duhet përpjekje dhe aftësi për të prodhuar informacion raportimi të mirë të bazuar në analiza dhe të mbështetur nga prova. Praktika në sektorin publik tregon se shumë shpesh raportimi i informacionit fokusohet në veprimet e përditshme rutinore më shumë sesa në analizën e arritjeve. Kapaciteti mund të përmirësohet përmes udhëzimeve, trajnimit dhe praktikës.

Sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit i propozuar përbëhet nga dy nivele:

I. Niveli i parë lidhet me monitorimin e projekteve duke ndjekur me vëmendje arritjen e indikatorëve të përcaktuar në këtë dokument. Ky proces do të realizohet nga strukturat përgjegjëse brenda dhe në varësi të BT-së. Raportet e monitorimit të këtyre strukturave do të dërgohen tek struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe jetësimin e prioritetëve në BT. Periodiciteti i monitorimit është vendosur bazuar në specifikat që ka çdo projekt.

II. Niveli i dytë lidhet me vlerësimin e përmbushjes së objektivave dhe rezultateve të pritshme. Ky vlerësim do të realizohet çdo fund viti, ku nëpërmjet analizës së raporteve të monitorimit do të vlerësohet masa e përmbushjes së objektivave, krahasimi i masës së arritjeve me masën e parashikuar, si edhe në raste të veçanta do të propozohen edhe ndryshime në projekte, kohëzgjatje, afate, fonde etj.

Monitorimi i SVR-së është fazë shumë e rëndësishme dhe matësi më i mirë i suksesit në zbatueshmërinë e saj. Puna do të nisë bazuar në procedurat administrative për të siguruar raporte mbi zbatimin e projekteve të ndryshme. Pastaj, gradualisht do të përmirësojmë cilësinë e informacionit të krijuar gjatë procesit dhe përfundimisht ky informacion do të përdoret në sistemin e vendimmarrjes.

Bazuar në kalendarin e monitorimit të strategjisë çdo vit do të përgatiten vlerësimet e ecurisë së SVR-së dhe do të raportohet tek Kryetari lidhur me ecurinë e punës për përmbushjen e objektivave strategjike. Në varësi të ecurisë së punës mund të propozohen edhe rishikime të objektivave strategjike. Në varësi të specifikave që kanë monitorimi/raportimi i projekteve do të kryehet në periudha 3 – 6 mujore. Raportet do t'i dërgohen strukturës përgjegjëse sipas afateve të përcaktuara. Vëmendje të veçantë i është kushtuar indikatorëve si sinjalizues të ecurisë së punës.

